

VENDIM
Nr. 309, datë 16.5.2018

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KRIJIMIT TË SHOQËRISË “AIR ALBANIA” SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton procedurat për krijimin e shoqërisë së përbashkët me përgjegjësi të kufizuar “AIR Albania”, e cila do të operojë në fushën e transportit ajror në përputhje me dispozitat e Kodit Ajror.

2. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “AIR Albania” do të krijohet ndërmjet ortakëve, “Albcontrol” sh.a., që përfaqëson palën shtetërore shqiptare dhe subjekteve të interesuara *Turkish Airline* e “MDN Investment” sh.p.k.

3. Shoqëria “Albcontrol” sh.a., autorizohet të përfaqësojë pronarin shtet për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me ortakët e tjerë të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, për krijimin e shoqërisë së përbashkët dhe përcaktimin e kuotave të ortakëve në këtë shoqëri, brenda 10 (dhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, bazuar në rezultatet e nxjerra nga vlerësimi i kapitalit dhe i të drejtave të ofruara nga shoqëritë gjatë këtyre negociatave. Në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi pronari shtet, përfaqësuar nga “Albcontrol” sh.a. së bashku me ortakun tjetër shqiptar “MDN Investment”, sh.p.k., duhet të zotërojë jo më pak se 51% të kuotave të shoqërisë së përbashkët “AIR Albania”.

4. Marrëveshja e ortakëve për krijimin e shoqërisë së përbashkët “AIR Albania” duhet të përmbajë detyrimisht kërkesat e legjislacionit në fuqi, si më poshtë vijon:

a) Përkufizime, interpretime, natyrën dhe objektin e punëve që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga partneri privat;

b) Kohëzgjatjen e marrëveshjes;

c) Pronësinë e aseteve dhe detyrimet e palëve;

ç) Qëllimin e aktivitetit të shoqërisë që do të krijohet;

d) Çështjet e kapitalit e të ndarjes së fitimeve;

dh) Çështjet e qeverisjes së shoqërisë sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

e) Të drejtat dhe detyrimet e institucioneve përgjegjëse;

ë) Sanksionet në rast mospërmbushjeje të detyrimeve;

f) Të drejtat e institucionit përgjegjës ose të një autoriteti tjetër publik për të monitoruar punët që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga partneri privat;

g) Principet komerciale, financiare dhe ligjore;

gj) Çdo kufizim ose kusht të zbatueshëm për transferimin e të drejtave dhe të detyrimeve të partnerit privat, marrjen e vendimeve etj., sipas marrëveshjes dhe legjislacionit ndërkombëtar të aplikueshëm në Republikën e Shqipërisë;

h) Trajnimet e stafit, transferimin dhe ngritjen e kapaciteteve;

i) Çdo kufizim ose kusht për transferimin e një interesi kontrollues të partnerit privat;

j) Përkufizimin dhe pasojën e forcës madhore, ndryshimin në ligj dhe ndryshime të tjera në rrethana (duke përfshirë çdo të drejtë të palëve për të kërkuar kompensimin ose rishikimin e marrëveshjes);

k) Përgjegjësinë sociale;

l) Garancitë për t'u përmbushur dhe politikat e sigurimeve dhe të të drejtave të punonjësve që duhet të ndiqen nga shoqëria gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;

- ll) Procedurat e rregullimit të shkeljes së bërë nga njëra prej palëve;
- m) Kushtet dhe procedurat për ndryshimin dhe/ose përfundimin e marrëveshjes, të drejtat dhe detyrimet e palëve, me kalimin e afatit apo përfundimin e tij;
- n) Ligjin e zbatueshëm dhe mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet institucionit përgjegjës dhe partnerit privat;
- nj) Procedurat e largimit të partnerit privat nga shoqëria e përbashkët pas kalimit të një afati të caktuar ose për arsye të tjera.

5. Shoqëria “Albcontrol” sh.a., paraqet për miratim tek organet e veta të shoqërisë, përkatësisht në Këshillin Mbikëqyrës dhe Asamblenë raport të detajuar për negociatat dhe për të gjitha elementet e marrëveshjes, përfshirë tekstin përfundimtar të marrëveshjes për krijimin e shoqërisë së përbashkët të sjellë në formën ligjore të kërkuar. Marrëveshja e nënshkruar hyn në fuqi pas miratimit në Këshillin e Ministrave.

6. Pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe me hartimin e akteve të tjera për krijimin e shoqërisë së përbashkët “AIR Albania”, autorizohet “Albcontrol” sh.a. të përfaqësojë pronarin shtet në procedurat ligjore të krijimit dhe regjistrimit si subjekt tregtar të “AIR Albania”, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

7. Emërtimi i shoqërisë “AIR Albania” të regjistrohet si markë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale nga “Albcontrol” sh.a.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe “Albcontrol” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama